



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:258947

Datë: 26.06.2023

Numri i dokumentit: 04428926

PPP.nr.177/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A, me seli në Prishtinë, Rr. “Nëna Terezë” nr.36, kundër debitorit B.A nga P, Rr..., lidhur me çështjen përmbartimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.8/20 të datës 31.01.2020, të lejuar nga Zyra Përmbartimore - Përmbartuesi Privat I.SH në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.06.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit B.A nga P, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.8/20, të datës 31.01.2020, të lejuar nga Zyra Përmbartimore – Përmbartuesi Privat I.SH në Prishtinë.

II. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, **OBLIGOHET** që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 3,222.87 € (Euro).

III. Në rast se debitori dështon të paguajë shumën e lartëcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat I.SH në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A, me seli në Prishtinë, ka lëshuar Urdhërin për Përmbartim P.nr.8/20, të datës 31.01.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti nga librat afaristë me shifrën D, me të cilin Urdhër është obliguar debitori që në emër të shërbimeve të furnizimit dhe konsumimit të energjisë elektrike për periudhën nga data 11.10.2007 deri me datën 20.03.2013, t’ia paguajë kreditorit

borxhin në shumë prej 3,222.87 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të Urdhërit, me kamatë prej 8%, duke e llogaritur nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive të borxhit.

Kundër këtij Urdhëri mbi lejimin e përmbarimit, brenda afatit të paraparë ligjor prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim ndër tjera debitori i është referuar dispozitës nga neni 360 të LMD-së, duke pretenduar se kemi të bëjmë me borxh i cili është parashkruar dhe kreditori ka humbur të drejtën e borxhit në fjalë. Më tutje theksohet se ekzistimi i raportit juridiko - civil në rastin konkret nuk mund të pranohet si raport real vetëm në bazë të deklaramit të njëanshëm në propozim për përmbarim, pasi deklaramet e njëanshme nuk ofrojnë mundësi që shkresat e tilla të kualifikohen si bindëse për gjykatën. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar Gjykatës që pas shqyrtimit të prapësimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike të merr aktvendim me të e aprovon prapësimin si të bazuar dhe e shfuqizon urdhërin përmbarimor.

Përgjigje ndaj prapësimit të debitorit ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, duke theksuar se propozimi për përmbarim është bërë për periudhën 11.10.2017 deri me datën 20.03.2013, duke iu bashkuar në propozim për përmbarim Ekstrakti nga librat afaristë, tek kriteri minimal është i precizuar borxhi kumulativ, jo i ndarë nga faturë për faturë mujore. Vlera në të cilën është kërkuar borxhi i papaguar është i shtypur në propozimin për përmbarim, ndërsa me pagesat reciproke të pa definuara është mbuluar borxhi deri në datat e propozimit të bërë. Më tutje theksohet se debitori me dt.30.08.2016 ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit, deklaratën mbi dakordimin e borxhit për 18 këste, ndërsa debitori ka bërë pagesë me datë 21.08.2019, kësti i 13, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve. Megjithatë, debitori ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ (QRK) – Nr.04/2015 për Procedurat e Faljes së Borxheve Publike, nenit 10, dhe në këtë mënyrë për shkak të mos pagesës së 11 kësteve vlera e falur e borxhit i është rikthyer, ndërsa pagesa e bërë në emër të shpenzimit të energjisë elektrike i është minusuar në vlerën e përgjithshme dhe vlera e mbetur është 3,222.87 Euro. Bazuar në pretendimet e lartëcekura, i ka propozuar Gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi dhe të mbetet në fuqi Urdhëri për lejimin e Përmbarimit.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi nuk është i bazuar, nga arsytet në vijim:

Dispozita nga neni 29 par.1 e LPP-së, ka paraparë llojet e dokumenteve të besueshme, në bazë të të cilave mund të caktohet përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla. Në nënpar 1.2 të këtij neni përcaktohet: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në rastin konkret, propozimi për përmbarim është lejuar në bazë të ekstraktit nga librat afaristë me shifrën D, në bazë të të cilit konstatohet se borxhi i papaguar i debitorit në raport me

kreditorin në emër të shërbimeve vtë furnizimit dhe konsumit të energjisë elektrike për periudhën kohore 11.10.2007 – 20.03.2013 arrin shumën prej 3,222.87 Euro.

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës erdhi në përfundim se ekstrakti i lartëcekur i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i besueshëm në kuptim të dispozitës nga neni 29 par.1 nënpar 1.2 të LPP-së, rrjedhimisht është i përshtatshëm për përmbarrim dhe shërben si bazë për caktimin e përmbarrimit në këtë çështje përmbarrimore.

Me rastin e vendosjes, Gjykata mori parasysh pretendimin e debitorit se kemi të bëjmë me borxh të parashkruar dhe se kreditori e ka humbur të drejtën për ta kërkuar një borxh të tillë. Lidhur me pretendimet e tilla. Gjykata nga shqyrtimi i shkresave të lëndës gjeti se mes palëve ndërgjyqëse me dt.30.08.2016, është arritur dakordim mbi faljen e borxhit të akumuluar për periudhën deri me dt.31.12.2008 në shumë prej 3,082.53 Euro, si dhe nga janari 2009 në shumë prej 504.34 Euro. Përmes kësaj deklarate, palët janë pajtuar që borxhi të paguhet në 18 këste dhe vlera e këstit të përcaktuar ka qenë në shumën prej 28.00 Euro. Sipas vlerësimit të Gjykatës, me rastin e nënshkrimit të kësaj deklarate, debitori konsiderohet se ka hequr dorë nga parashkrimi, gjegjësisht e ka pranuar një detyrim të parashkruar. Bazuar në kohën kur pretendohet të ketë lindur raporti juridik, Gjykata iu referua Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e ish RSFJ) i datës 30 mars 1978, i cili në nenin 365 parasheh që: *“Debitori nuk mund të heqë dorë nga parashkrimi para se të ketë kaluar koha e caktuar për parashkrimin. Në anën tjetër, neni 366 par.1 i të njejtit ligj parasheh që: ‘Njohja me shkrim e sigurimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi’*. Debitori pas kësaj deklarate ka bërë pagesa të kohë pas kohshme në emër të përmbushjes së kësteve, por nuk iu ka përmbajtur në tërësi marrëveshjes, duke rënë në vonesë në përmbushjen e kësteve, për çka Gjykata iu referua nenit 10 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2015 për Procedurat e Faljes së Borxheve Publike, i cili parasheh që *“Në rastet kur personi shkakton tri vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas programit të pagesës së borxhit sipas marrëveshjes, pjesa e paguar e borxhit i fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”*. Bazuar në këtë fakt, si dhe meqenëse nga data e lidhjes së marrëveshjes, pagesa e fundit e kryer nga debitori ka qenë me dt.21.08.2019 në shumë prej 28.00 Euro, që përputhet me vlerën e këstit mujor të dakorduar, rrjedh se i njejtë e ka ndërprerë afatin e parashkrimit në kuptim të nenit 387 të LMD-së, i cili parasheh që *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin. Pohimi i borxhit mund të blihet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyrë indirekte, siç janë dhënia e kisteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit”*. Në këtë mënyrë, bazuar në faktin se nga momenti i pagesës së dt.21.08.2019, e deri në momentin e paraqitjes së propozimit për përmbarrim me dt.31.01.2020 nuk ka kaluar afati i paraparë prej një (1) brenda të cilit kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, rrjedhimisht nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës.

Bazuar në këto rrethana, meqë Gjykata vlerëson se meqë nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e parapara me dispozitën e nenit 71 të LPP-së, mbi bazën e të cilave mund të anulohet urdhëri për lejimin e përmbarrimit, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit në kuptim të nenit 73 të LPP-së.

Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi debitorin që në rast të parashtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 3,222.87 Euro, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën III të dispozitivit e paralajmëroi debitorin se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Nga arsyet e lartëcekura, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.177/20, datë 23.06.2023

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.